

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës – Pune

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROKURIMIT: Rikonstruksion Godina e Bashkise

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 45210000-2
Puna e ndërtimit**

VLERA E FONDIT LIMIT: 10.000.000 (dhjete milion) leke pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Rrogozhinë** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar.

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Sipas kërkesave të përcaktuar në Kriteret e Përgjithshme të Pranishme të Pranimi/Kualifikimit.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të certifikuara të bilanceve të 3 (tri) viteve të fundit financiare (2023, 2024,2025) të paraqitur në Autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky Autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në dy balance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivit).Shënim: Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të

Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe Nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në Nenin 29 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore” “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në Udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në Udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji”.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenin 41 shkronja c” të Ligjit nr. 1009/2009: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikim të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë **dy prej tre treguesve të mëposhtëm:** i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej **50 milionë lekësh;** ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej **100 milionë lekësh;** iii) ka, mesatarisht, **30 të punësuar** gjatë periudhës kontabël”

2. Kopje të deklarimit të xhiros vjetore gjatë 3 (tri) viteve të fundit financiare (2023, 2024,2025) lëshuar nga Autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së kontratës që po prokurohet. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 43, neni 55 pika 4.

Ky kriter kualifikues i sherben Autoritetit Kontraktor per te vertetuar se operatori ekonomik fitues zoteron te gjitha kapacitett financiare dhe ekonomike per te permbushur kontraten.

3. Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2025 sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i

ndryshuar). Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetedeklarimit, dokumentet përkatëse vërtetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).

Argumentimi. Kërkesa e mësipërme është përcaktuar sipas Nenit 76 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; Kreut V, Seksioni III, Nenin 43, pika 6 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe sipas Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar), ku në zbatim të legjislacionit në fuqi, Qendra Kombëtare e Biznesit ka funksion të mbajë regjistrin tregtar dhe për qëllim të regjistrimit fiskal, në të cilin përcaktohen dhe vendet e ushtrimit të operatorëve ekonomikë, duke qënë se këto të fundit kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre
Kjo kërkesë është vendosur me qëllim që AK të ketë mundësinë të shohë nëse OE pjesëmarrës kanë apo jo detyrime ndaj NJ.Q.V, fakt që tregon fleksibilitetin e tyre financiar.

2.3 Kapaciteti teknik:

Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:

1. Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

- a.** Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.
- b.** Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është në një vlerë jo më të vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njerit prej dy kushteve të sipërpermendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.

1.2 Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Formular vleresimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i përfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer);
 - Kontratë Sipërmarrje;
 - Situacionin përfundimtar;
 - Aktin e kolaudimit;
 - Çertifikatën e marrjes në dorezim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorezim.
- b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - a) Kontrate Sipërmarrje;
 - b) Situacionin përfundimtar;
 - c) Fatura tatimore perkatese të Deklaruara në organet tatimore.
- 1.3** Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontraten e Bashkimit të operatoreve ekonomik si dhe prokurën e posaçme të deklaruar në fazën e tenderimit.
- 1.4** Për kontratat e realizuara si nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: kontratën bazë ndërmjet kontraktorit dhe autoritetit kontraktor, kontratën e nënkotraktimit dhe aktin e miratimit zyrtar si nënkontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat..50 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose minimalisht sa dyfishi i fondit limit, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar me sukses kontratën objekt prokurimi, sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Në mbështetje të Nenit 88, pika 3 e VKM 285/2021, parashikon se: “Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht”

Në mbështetje të Nenit 88, pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se: “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve”.

Pra në rastet e BOE, dokumentacioni i kërkuar për të vertetuar përvojen e meparshme si kontrata e bashkepunimit, disponohen nga çdo OE në rastin kur ka qene pale në Bashkimin e OE. Ky dokumentacion është lehtësisht i aksesueshëm dhe është pjesë e dosjes së zbatimit të punimeve të kontratës që ka çdo shoqëri në dosjen e saj në rastin kur ka qene në atë status, e për rrjedhojë nuk është në kundërshtim me asnjë nga dispozitat ligjore të prokurimit publik dhe nuk sjelle asnjë kufizim të pjesëmarrjes së OE në procedurën e prokurimit në fjalë.

2.3.2 Liçensa profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës.

Operatori Ekonomik duhet të disponojë Liçencë të shoqërisë e vlefshme për kategoritë e mëposhtme:

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit kompania duhet të ketë liçensat e mëposhtme:

- | | | | |
|---|--------------|---|-----------------|
| • | N.P-1 | (Punime germimi e toke) | Niveli A |
| • | N.P-3 | (Rikonstrukcion dhe mirembajtje godinash civile e industriale,) | Niveli A |

sipas modelit të lëshuar nga institucioni përgjegjës për dhënien e licensave profesionale sipas legjislacionit në fuqi.

Operatorët e huaj duhet të barazvlerësojnë (ekuivalentojnë) liçencat profesionale që ata kanë lëshuar nga vendi i origjinës, në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, (ose Ministrinë kompetente) në Republikën e Shqipërisë. (Rregullore për kriteret dhe procedurat për lëshimin e licensave profesionale për zbatimin, klasifikimin dhe disiplinimin e personave juridikë që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, miratuar nga VKM, Nr. 42, datë 16.01.2008).

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendim të Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Gjithashtu, të dhënat për liçencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, Ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, Neni 8 përcakton “Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me liçencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standardet kombëtare ose europiane” si dhe Udhëzimit nr. 2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, pika 1.1 ku përcaktohet se: çdo subjekt juridik i licencuar ka të drejtë të ushtrojë veprimtari zbatimi, vetëm në klasat dhe kategoritë e punimeve, që ka përcaktuar në liçencë. Kushtet dhe kriteret, që duhet të plotësojë subjekti juridik për të fituar klasa e kategori në zbatimin e punimeve të ndërtimit, përcaktohen në rregulloren për dhënien e licensave profesionale, që miraton Ministri i Rregullimit të Territorit dhe i Turizmit.*

NP-1 A

Punime gjermimi në tokë

Sipas VKM nr.42 të datës 16.01.2008, punime gjermimi në tokë konsiderohen gjermimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjeti, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gjermohet ose sistemohet vegjetale, argjilore, ranore, zhavorrishte ose shkëmbore.

Vendosja e kësaj pike license si kriter lidhet me zbatimin e punimeve të parashikuara të realizohen nëpërmjet kësaj procedure. Dokumentacioni teknik i hartuar nga projektuesi parashikon punime gjermimi dhe sistemimi të dherave. Të tilla punime përfshihen në zërat e punimeve të gjermimit të dheut. Kategoria A i referohet vlerës totale të këtyre punimeve në preventivin e projektit të zbatimit.

N.P - 3 A

(Rikonstrukcion dhe mirembajtje godinash civile e industriale,)

Sipas VKM nr.42 të datës 16.01.2008 më sipër cituar punime të tilla konsiderohen zgjidhjet dhe koordinimi i punimeve të specialiteteve të nevojshme për rikonstrukcionin dhe mirëmbajtjen e godinave. Këto punime janë parashikuar në preventiv. Për zbatimin e punimeve të tilla është e nevojshme që të anagzhohen subjekte të specializuara, të cilët zotërojnë licensën N.P – 3 Kategoria A i referohet vlerës totale të këtyre punimeve në preventivin e projektit të zbatimit

2.3.3 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, të përfshirë në licencën e shoqërisë, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, librezë pune, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, konkretisht:

- Minimuni **1 (një) Inxhinier Ndertimi**
- Minimuni **1 (një) Arkitekt**

-Operatori ekonomik duhet të deklarojë se Drejtuesit Teknik të mesipër janë të punësuar në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”.

Per drejtuesit Teknik të kerkuar të paraqitet:

- i. C.V (përkatëse)
- ii. Kontrate pune të vlefshme (përkatëse)
- iii. Diplomë

(Në rastin e Bashkimit të Operatoreve Ekonomik secili Operator duhet të plotësojë pikat dhe deklaratat e mesipërme në varesi të vlerës dhe zerave të preventivit të punimeve që ka marrë për sipas përqindjes së bashkëpunimit).

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetedeklarimit dhe deklaratave të mesipërme, dokumentet përkatëse vërtetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).

Shenim : Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë për inxhinieret e mesiperm, emer/mbiemer, atesia, numrin personal të ID , numrin dhe titullin e kualifikimit për diplomën përkatëse, si dhe institucionin që ka lëshuar këtë dokument.

Argumentimi: Këto kritere i shërbejnë Autoritetit Kontraktor për tu bindur se OE zotëron kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, aftësitë organizative, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Këtu nga AK janë përcaktuar kriteret e nevojshme për personelin e kualifikuar sipas niveleve të ndryshme të kualifikimit dhe profileve të nevojshme mbështetur në tipologjinë e punimeve, si dhe kërkesat për fuqi punëtore referuar përmasave dhe natyrës së kontratës, objekt prokurimi.

Në kërkesat për personelin e kualifikuar nga AK janë kërkuar disa kategori personeli, të domosdoshëm për të kryer të gjitha shërbimet e nevojshme dhe mbulimin e të gjitha hallkave/etapave të zbatimit të projektit, sipas nivelit të kompetencave profesionale deri në realizimin e plotë të veprës.

2.3.4 Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre personel të kualifikuar/certifikuar si:

- a) **1 (një)** punonjes i pajisur me çertifikate **“Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave”** e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave. (Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) punonjës "Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave").
- b) **1 (një)** inxhinjer si **“Ekspert zjarrfikës”** në përputhje me pikën 4, të nenit 49, të Ligjit Nr.152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”. Për këtë duhet të paraqitet Certifikate/dëshmi për ekspert zjarrfikës të lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme, diploma dhe kontrata noteriale e punës si dhe të rezultojë në listëpagesat e shoqërisë për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave. Në rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh ky kriter plotësohet nga anetari që do të kryejë punimet e MNZ. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit dhe deklaratave të mesipërme, dokumentet përkatëse vërtetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kërkesa e mesipërme mbështet në ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" Neni 7 Shërbimet e mbrojtjes dhe të parandalimit ... 1. Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarres, që të merren me ceshtjet e mbrojtjes, të sigurojnë e shëndetit në punë dhe të parandalimit të rreziqeve profesionale në ndërmarrje /institucion ..., dhe V.K.M nr.312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier ". Autoriteti Kontraktor ka qellim realizimin e kontratës objekt prokurimi sipas kushteve të përcaktuara në DST, duke respektuar çdo rregull lidhur me kantierin e ndërtimit si dhe me sigurinë e punonjesve gjatë

ushtimit te veprimtarise se punes. Eshte e rendesishme qe punimet te realizohen brenda nje kantieri te sigurt duke mbrojtur jeten e punonjesve, por dhe te kalimtareve qe mund te jene perreth vendit te punimeve. Per sa me lart, punonjesi i cili eshte i certifikuar si "Pergjegjes per sigurine dhe mbrojtjen e shendetit ne pune", nepermjet dijes dhe eksperiences te fituar ne kete fushe, duhet te shmange apo parandaloje cdo rrezik qe mund te shfaqet gjate veprimtarise se shoqerise dhe qe mund te cenoje shendetin apo sigurine ne pune. Ne keto kushte, vendosja e ketij kriteri sherben si nje garanci qe ofertuesit do te realizojne punimet sipas standarteve ligjore ne fuqi.

Bazuar dhe ne V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier". Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.

Garantimi i ekspertizës së mbrojtjes nga çdo rrezik dhe të papritur në punë dhe dokumentat përkatëse të personave përgjegjës i shërbejnë autoritetit për të krijuar bindjen dhe besueshmëri për realizimin e kontratës.

Gjithashtu kërkesa për Ekspert zjarrefikes është në përputhje me pikën 4, të nenit 49, të Ligjit Nr.152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin", duke patur parasysh qe nje ze i rendesishem ne preventiv eshte edhe Sistemi i Mbrojtjes kunder Zjarrit Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", në anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet te kete nje punesim mesatar minimumi **20 (njezet)** punonjes te vertetuar me: Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave dhe listpagesat perkatase të konfirmuara nga autoritetet përgjegjëse, shoqëruar me formularët e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit, dokumentet perkatase vertetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).

Argumentimi: Përcaktimi i numrit të punonjësve është bërë bazuar tek faktorët, si volumet dhe kategoritë e punimeve, kualifikimi i punonjësve, grafiku i punimeve, zërat e punimeve dhe orët e punës dhe pagën minimale të lejuar që duhen për të përmbushur kontratën. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështirje për 3 (tre) muajt e fundit, të deklaruar nga data e hapjes së ofertave tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar/të kualifikuar**, si dhe të përfshirë në listepagesa për periudhën 3 muajt e fundit;

a. profesionet si mëposhtë:

- 1 (një) Teknik ndertimi
- 1 (nje) punonjes hidraulik
- 2 (dy) punonjes elektrikist
- 2 (dy) punonjes pllakashtrues
- 2 (dy) punonjes Hidroizolues
- 2 (dy) punonjes Bojaxhi
- 1 (nje) punonjes Dyer Dritare

Krahas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës perkatese në DST, për punonjësit me profesionet si më sipër, operatorët ekonomikë duhet të plotësojnë dhe të paraqesin tabelën me të dhënat si më poshtë:

Nr.	Emër Mbiemër I punonjësit	Profesioni	Institucioni shtetëror/privat lëshues I certifikatës/diplomës	Nr NIPT (Në rast se lëshuesi është institucion privat)
1.				
2.				
etj.				

* Disponimi i stafit/ punonjësve sipas specialitetit të kërkuar, duhet të deklarohet nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës perkatese në DST, si dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, për secilin punonjës, duhet të paraqesë dokumentacionin: Për specialistët e sipercituar sipas profesioneve, duhet të paraqiten, deshmitë/certifikatat ose cdo dokument tjetër që verteton diplomimin/trajnimin/ose kualifikimin e tyre sipas profesionit, si dhe kontratat individuale të punës të vlefshme.

- Kontrata e punës e vlefshme,
- Dëshmi/ certifikatë kualifikimi të lëshuara nga institucione publike/ private të licensuara për kurset e ofruara, sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” për specialistët, ndërsa për teknikët duhet të paraqiten diplomat e shkollës së mesme/ ose te larte,
- Secili specialistë i sipercituar sipas profesioneve, duhet të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën 3 muajt e fundit, nga data e zhvillimit të tenderit.

b) Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës perkatese në DST, se ka pjesë të stafit të

punësuar minimumi **1 (nje)** shoferë dhe **1 (nje)** manovratorë, të cilët duhet të figurojnë në listëpagesa të shoqërisë në rastin kur mjetet/makineritë e deklaruar janë në pronësi të operatorit ekonomik ofertues, në të kundërt kur mjetet/ makineritë disponohen me qera, ky staf i kërkuar mund të jetë i kontraktuar, **dhe në çdo rast, në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, për secilin të paraqiten:**

- Kontratë pune të vlefshme,
- Dëshmi kualifikimi nga organet përkatëse sipas ligjit,
- Për stafin manovratorë/automaknist të paraqiten: Dëshmi e aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda të ndërtimit dhe punimeve në tokë (të vlefshme) lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor;

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Në kriterin sipercituar është kërkuar që OE të kenë të punësuar teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, sipas fushave që përfshijnë punimet për zbatimin e projektit.

Këtu përfshihen kërkesat për punonjësit, të cilët janë trajnuar/certifikuar për kryerjen e punimeve të caktuara të zbatimit, pasi kanë kryer me sukses kurse dhe trajnime profesionale për punimet respektive. Zbatimi i punimeve që përfshin projekti duhet të kryhet nga fuqi punëtore e kualifikuar për secilën tipologji punimesh. Punëtorët e ndërtimit dhe profesionet e lidhura me to ndërtojnë, mirëmbajnë dhe riparojnë ndërtesat dhe strukturat e tjera që nga themelet, muret dhe pjesët e tjera kryesore të ndërtesës dhe konstruksione të tjera, si jashtë ashtu edhe brenda duke përdorur teknika dhe materiale tradicionale apo moderne të ndërtimit. Ata kryejnë punime murature, , shtrim pllakash dhe asfalti etj. Nisur nga punimet e parashikuara të zbatimit, në kriteret e veçanta janë kërkuar punëtorët e kualifikuar si vijon:

Percaktimi i numrit te punonjesve dhe profesionet eshte bazuar mbi zerat dhe volumet e punes si dhe afateve per perfundimin e punimeve, ne mbeshtetje te Manualit te ndertimit miratuar me Vendim Nr. 216, datë 13.4.2023.Bazuar ne kater elementet e struktures se kosos(material, puntori, makineri, transport).Numri i punonjësve, dhe profesionet që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 date 10.09.1998 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore

Vendosja e këtij kriteri lidhet drejtpërdrejtë me mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës.

2.3.7 Operatori/et ekonomik duhet të paraqesin certifikatat e cilësisë së punimeve, per objektin qe prokurohet, te cilat duhet te jene te perkthyer ne gjuhen shqipe dhe te noterizuara, sipas standardeve:

1. Certifikatën e cilësisë së punimeve SSH/DIN/EN/UNI **ISO 9001-2015** e përditësuar, e vlefshme/ose/ekuivalent. Certifikata të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
2. Certifikatën për Sistemin e menaxhimit të mjedisit SSH/DIN/EN/UNI **ISO 14001-2015** e përditësuar, e vlefshme /ose/ ekuivalent. Certifikata te jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të

konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

3. Certifikatën SSH/DIN/EN/UNI **ISO 45001:2018** e përditësuar, (SSH/DIN/EN/UNI **ISO 45001 – 2023**) e vlefshme/ ose ekuivalent (Mbi Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë të punëtorëve në punë ose ekuivalent). Certifikata të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 39, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Për vet natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësisë, mjedisit dhe shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarde që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës për sa kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.

- 2.3.8** Operatori ekonomik duhet të ketë në dispozicion apo mund t’i vihen në dispozicion mjetet e pajisjet teknike të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, si me poshte (sipas formularit permbledhes te vetedeklarimit):

<i>Mjetet</i>	<i>Sasia</i>	<i>Gjendja</i>
Kamion veteshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 10 - 12 ton	1 copë	Pronësi ose me qera
Kamioncine (kapaciteti mbajtës deri në 3.5-5 ton	1 copë	Pronësi ose me qera
Kamioncine me vinc kapacitet mbajtës 1.5- 2 ton	1 copë	Pronësi ose me qera
Autobetoniere me kapacitet mbajtës 2.5-3.5 m3 (Mjet teknologjik me Goma)	1 copë	Pronësi ose me qera
Minifadrome(Mjet teknologjik me Goma)	1 copë	Pronësi ose me qera
Skeleri	M2	200

Të paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë:

- Kokore minimumi 20 copë
- Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila minimumi 2 copë
- Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 4 copë

- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 10 copë

a) Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë); b) leje qarkullimi; c) certifikate e kontrollit teknik (e vlefshme); d) siguracion mjeti (i vlefshëm); e) certifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme).

b) Për mjetet e deklaruar me qera duhet të paraqitet a) dokumenti që verteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë) b) leje qarkullimi; c) certifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme) ç) siguracion mjeti (i vlefshëm);

c) Për pajisjet teknike, të cilat janë në pronësi të operatorit ekonomik, duhet të paraqitet kontrata e shitblerjes/fatura tatimore e shitjes ndërsa kur janë të marra me qera duhet të paraqitet kontrata e qerasë, fatura tatimore e shitjes/ kontrata e shitblerjes. Në rastin kur fatura është lëshuar nga subjekte që nuk janë të regjistruar si tatimpagues të TVSH-së duhet të shoqërohet me kuponin tatimor.

d) Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të treguara duhet të jetë e dukshme në një foto të vetme mjeti dhe targa e tij.

- Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës deklaron se mjetet dhe pajisjet e deklaruar nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruar në procedurat të shpallura fitues.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për vendndodhjen e mjeteve në pronësi ose me qera me qëllim verifikimi nga Autoriteti Kontraktor.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri dhe lloji i makinerive, pajisjeve në pronësi / qira / kontrate furnizimi janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke ju referuar punimeve sipas standardeve, orëve të punës, grafikut dhe kohëzgjatjes së punimeve, specifikimeve teknike. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomik duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe asetëve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asetëve të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.

Kerkesa per pajisjen me makinerite e mesiperme eshte e nevojshme per arsyet si meposhte:

Mjetet	Sasia	Referencat në vendosjen e kriterit
Kamion veteshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 10 - 12 ton	1 copë	Eshte I nevojshme per transportin e materialeve te ndryshme
Kamioncine (kapaciteti mbajtës deri ne 3.5- 5 ton	1 copë	Për transportin e materialeve të ndërtimit brenda dhe jashtë kantierit sipas nevojave të punës dhe sasisë, tipologjitë e materialeve që do të transportohen nevojitet kamioncine me kapacitet mbajtës 3.5-5 Ton. Për këtë qëllim është kërkuar 1 kamionçin. Ky numër është minimumi i nevojshëm në raport me
Kamioncine me vinc kapacitet mbajtes 1.5- 2 ton	1 copë	Për transportin e materialeve të ndërtimit brenda kantierit sipas nevojave të punës dhe sasisë, tipologjitë e materialeve që do të transportohen nevojiten kamionçina me vinc me kapacitet mbajtës 1.5 – 2ton Ton. Ky numër është minimumi i nevojshëm në raport me vëllimin e
Autobetoniere me kapacitet mbajtes 2.5-3.5 m3 (Mjet teknologjik me Goma)	1 copë	Per prodhim dhe transport betoni
Minifadrome(Mjet teknologjik me Goma)	1 copë	Per punime germimi, nivelimi, dhe ngarkim materiale te dala nga prishjet apo germimet
Skeleri	200 m2	Per punime fasade e tavani

Mjete mbrojtese	Sasia	Referencat në vendosjen e kriterit
Kokore	10 cope	Referuar numrit te punonjesve
Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila	2 cope	Referuar rregullores "Për sigurinë në kantier" eshte gjykuar qe numri i dhjete fikseve te zjarrit,duke mbajtur parasysh se do punohet njëkohësisht në dy fronte pune është kërkesë minimale
Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi	5 cope	Referuar rregullores "Për sigurinë në kantier" eshte gjykuar qe numri i gjashtedhjte i tabelave te sigurimit teknik ,duke mbajtur parasysh se do punohet njëkohësisht në dy fronte pune është kërkesë minimale

Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi	2 cope	Referuar rregullores "Për sigurinë në kantier"
---------------------------------------	--------	--

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.